



Programi gjatë kohës së lirë, pas përfundimit të orarit të rregullt shkollor, në qendrat argëtuese

Për fëmijët 6 deri 9 vjeç (për klasët 1. deri 4.)

Cilat janë aktivitetet (çfarë bëhet) në qendrat argëtuese pas orarit të rregullt mësimor?

- Qendrat argëtuese pas mbarimit të programit (orarit) të rregullt shkollor ofrojnë programe të larmishme (shumëllojshme) që nënkupton lojëra të organizuara ose të përgatitura më parë apo të lira sipas dëshirës. Këto qendra angazhohen dhe përpiqen të ofrojnë tema argëtuese që ju ofrojnë fëmijëve zgjerimin e aftësive për lojëra dhe nevojave kreative të tyre.
- Aktivitetet e brendshme të këtyre qendrave, si programi, temat që ofrohen, dhe bashkëpunimi me palët jashtë këtyre qendrave bëhet në pajtim apo sipas kushteve dhe rrethanave të çdo vendi të punës.



Qendrat argëtuese marrin pjesë gjithandej në aktivitete bashkëpunimi me të tjerët në rrethinë, si për shembull me shoqëritë apo klubet sportive, për t'a zgjeruar dhe për t'a bërë më të shumëllojshëm aktivitetin e tyre.

- Fëmiju i juaj mëson islandishten përmes lojërave dhe aktiviteteve me bashkëmohatarët.
- Fëmiju i juaj njoftohet me bashkëmohatarët e tij.
- Fëmiju i juaj merrë pjesë dhe njoftohet me kulturën islandeze për fëmijë.
- Prindërit e njoftojnë qendrën argëtuese kur fëmiju duhet të shkojë në shtëpi, a shkon dikush me e marrë fëmijën apo fëmiju mund të shkojë në shtëpi i vetëm nga qendra argëtuese. Gjithashtu është e mundshme t'i njoftoni qendrat argëtuese nëse fëmiju i juaj, pas mbarimit të orarit në qendrat argëtuese, do të shkojë drejt në ndonjë aktivitet tjetër, si për shembull në ndonjë sport, orë muzikore apo në ushtrime muzikore në grupin e shkollës. Në disa raste ofrohet autobusi për ushtrimet sportive nga shoqëritë (klubet) e rrethit të afërt.



Rreth qendrave argëtuese pas programit (orarit) të rregullt mësimor

- Aktivitetet në këto qendra zhvillohen pas programit të rregullt shkollor, deri në ora 17:00 gjatë ditëve të punës.
- Ditëve të lira, gjatë Krishtlindjeve, për Pashkë dhe gjithashtu gjatë ditëve të mësuesve dhe ditëve të bashkëpunimit shkollë-prindër, qendrat argëtuese ofrojnë shërbimet e tyre për fëmijët që vijojnë këto qendra me një pagesë të caktuar për çdo ditë, jashtë orarit të përcaktuar gjatë ditëve të rregullta.
- Duhet kërkesë e veçantë për këto ditë (festave, ditëve të mësuesve dhe ditëve të bashkëpunimit shkollë-prindër) në çdo qendër argëtuese.
- Qendrat argëtuese pas mbarimit të programit të rregullt shkollor, gjatë kohës së pushimeve dimërore për shkollat fillore mbyllen.
- Qendrat argëtuese ofrojnë shërbimet e tyre gjithashtu gjatë verës.



Si të aplikohet në qendrat argëtuese pas mbarimit të rregullt të programit mësimor?

- Regjistrimi për vitin e ardhshëm shkollor fillon në shkurt. Aplikimi bëhet përmes Rafræna Reykjavík (www.rafraen.reykjavik.is). Konfirmimi i regjistrimit u dërgohet prindërve në gusht. Pë të gjitha ndryshimet në lidhje me regjistrimin duhet të njoftohen autoritetet e qendrës argëtuese.
- Nëqoftëse prindërit nuk mund të shfrytëzojnë aplikimin online, atëherë prindërit mund të shkojnë te qendrat argëtuese në rrethinën ku jetojnë për të marrë ndihmën e nevojshme për regjistrim. Nuk është i mundur regjistrimi përmes telefonit.
- Aplikimi vlen për një vit shkollor (gusht-qershor). Nëqoftëse shërbimet e qendres argëtuese dëshironi t'i ndërprisni, ose dëshironi ndryshime, duhet t'a bëni këtë para datës 15. të çdo muaj dhe tërheqja/ndërpreja juajë vlen nga muaji i ardhshëm. Është e mundshme që t'a ndërprisni shërbimin e qendrës argëtuese përmes Rafræn Reykjavík dhe me njoftim me shkrim te autoritetet e qendrës argëtuese.



Sa kushton qëndrimi në qendrat argëtuese pas programit të rregullt shkollor?

- Këtu, në linkun më poshtë, mund të gjinden tarifat e pagesës për qendrat argëtuese: <http://reykjavik.is/gjaldskrar/fristundaheimili-gjaldskra>
- Lartësia e pagesës mvaret nga numri i ditëve të qëndrimit në qendrat argëtuese.
- Për shërbimet pa rend aplikohen tarifa të veqanta pagese.
- Nëqoftëse dy apo më shumë vëllezër dhe/apo motra qëndrojnë/vendosen në qendrat argëtuese, ofrohet 75% zbritje për fëmijën e dytë dhe 100% për fëmijën e tretë dhe të katërt. Kusht është që vëllezërit dhe/apo motrat të kenë adresën dhe numrin familjar të njëjtë në Entin e Statistikës (Þjóðskrá). Prindërit paguajnë për ushqimin për të gjithë fëmijët.
- Ofrohet zbritje për vëllezërit dhe/apo motrat ndërmjet, prindërve të ditës (kujdestarëve për kujdesin gjatë ditës), kopshteve parashkollore dhe qendrave argëtuese, kështuqë 50% zbritje e pagesës për qendrën argëtuese, nëqoftëse fëmiju ka vëlla apo motër në kopsht parashkollor apo te prindërit e ditës (kujdestarët për kujdesin gjatë ditës).
- Fëmijët e moshave nga 6 deri 18 vjeç me vendbanim në Reykjavik marrin mbështetje financiare çdo vit, e ashtuquajtura Frístundakort. Prindërit mund t'a përdorin këtë mbështetje financiare (Frístundakort) për t'a zbritur pagesën në qendrën argëtuese apo për ndonjë aktivitet tjetër të lirë. Shikoni më hollësisht në linkun më poshtë: <http://reykjavik.is/thjonusta/fristundakortid>.

